



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 20 dhjetor 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1085\_2018

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15, dhe Dispozitat e Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 8 Paragrafët 4, 8 dhe 9 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Rregullën dhe metodologjinë për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 09.10.2018 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2019-2028;

**në seancën e mbajtur me datë 20.12.2018, nxori këtë:**

## **VENDIM**

### **I. MIRATOHET dokumenti Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2019-2028**

#### **Arsyetim**

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 09.10.2018 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2019-2028 nga KOSTT SH.A. Dokumenti është zhvilluar nga KOSTT duke u bazuar në Ligjin për Energji (L05/081) dhe Rregullën dhe metodologjinë për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë.

KOSTT më parë ka dërguar dokumentin për shqyrtim fillimisht me 14 shtator 2018. ZRRE ka dhënë komentet e veta në formë të shkruar të cilat komente janë përfshirë, si dhe janë sqaruar çështjet specifike të dokumentit dhe paqartësitë e ndryshme. Pas përfshirjes së komenteve të arsyeshme nga të gjitha palët, dokumenti është dërguar sërish me datë 04 dhjetor 2018, si version final për aprovim në ZRRE.

Pas komentimit dhe vlerësimit të dokumentit ZRRE konsideron se dokumenti i përmbush kriteret për miratim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke miratuar dokumentin **Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2019 - 2028**.



- II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2019-2028

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së**

Arsim Janova, u.d. kryesuesit

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar